

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

11.11.2024

Ora 15:26

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |   |
|------------|-----------|---|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar                                       |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar  |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar  |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar  |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar  |
| • Stafi    | KQZ       | Znj.J. Josifi, znj.P. Doçaj, znj.E. Demollari |
| Parti      | Politike: | PL (z. K. Kolndreu)                           |

**OJQ:**

**KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e vetëm një projektakti, projektvendim “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”. Për procedurë po ju pyes kolegë nëse ka çështje jashtë rendit të ditës që doni t’i diskutoni? Zoti Çakaj, po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit e nderuar!

**Znj. I. Nano:** Do ta diskutoni tani apo në fund të shqyrtimit?

**Z. M. Çakaj:** Jo më mirë tani.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë unë kisha dy-tre çështje të vogla, të cilat lidhen me, sipas vlerësimit tim, lidhen së pari me gjithë procesin e votimit, pra me procesin e hartimit të akteve nënligjore që na ngarkon Kodi Zgjedhor, me afatin respektiv dhe sigurisht me mënyrën e paraqitjes së tyre. Paraprakisht, unë e kam thënë dhe në mbledhjen e parë, referuar nenit 24 të Kodit Zgjedhor, i cili ka pësuar ndryshime në datë 26 korrik 2024, unë do të vlerësoja maksimalisht nëse prezantimin e këtyre akteve do ta bënte Komisioneri. Me keqardhje konstatoj që nuk denjon të vijë Komisioneri në mbledhjen e Komisionit Rregullator, edhe pas thirrjeve të herëpashershme që kemi bërë, si unë personalisht ashtu dhe kolegja Vukaj. Së dyti, në dy aktet e para që ne kemi miratuar, respektivisht aktin për regjistrimin e zgjedhësve dhe listën e dokumentacionit që duhet të disponojnë zgjedhësit, ne i kemi lënë detyrë administratës që mundësisht të bëjë një paraqitje grafike të mënyrës se si do shkojë procesi i regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë. Ende deri më sot nuk e disponojmë një paraqitje grafike. Nëse është e vështirë teknikisht, atëherë, nëse ne nuk paraqesim, nuk bëjmë dot një demo, si mund të bëjmë ne këtë proces? Është gjëja më e thjeshtë në botë! Nuk e di, ndoshta janë shumë të zënë, por i ftoj përsëri që ta bëjnë këtë, ta bëjnë të qartë për ne, ta bëjnë të qartë për të gjithë zgjedhësit nga jashtë dhe ta publikojnë në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Së treti, ne i kemi

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

bërë thirrje, i kemi dërguar dhe email zyrtar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që në momentin, që është hartuar matrica e akteve lidhur me votimin nga jashtë, kemi kërkuar në email zyrtar, unë dhe kolegja Vukaj që krahas titujve të akteve për votimin nga jashtë, të kishim edhe aktet, pra përmbajtjen e akteve, draftet e akteve. Ende sot, referuar matricës që na është dërguar, konstatojmë që nuk kemi drafte për dy akte, administrimin e votës dhe aktin përfundimtar për lejimin e të drejtës të votës nga jashtë. Më duhet të sjell në vëmendjen tuaj që afati përfundimtar i miratimit të akteve për votimin nga jashtë është data 15 nëntor, ende sot në datën 11 nëntor nuk kemi të paktën dy akte dhe kjo histori është shumë e shëmtuar! Pra, që ju nuk paraqisni asnjë draft, as ju si administratë, as Komisioneri nuk paraqisni asnjë draft ende sot s'e kemi dhe kërkoni të na vini, si të thuash, në vështirësi për miratimin e këtyre akteve. Realisht, po shkelen të gjitha afatet ligjore, jemi në afatin përfundimtar që nuk e kemi. Nuk mund të mbani ju 90 ditë në dispozicion, 80 e ca ditë dhe t'i lini Komisionit Rregullator, për gjithë rëndësinë që i ka ngarkuar, detyrat, tagrin, që i ka ngarkuar ligjvënësi, t'i lini vetëm dy apo tre ditë në dispozicion. Në gjykimin dhe vlerësimin tim kjo është krejtësisht e papranueshme! Kështu që le të merret si tërheqje vëmendjeje ndaj administratës, por edhe ndaj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjithashtu unë kisha pak vërejtje dhe për cilësinë e aktit që keni punuar. Me keqardhje konstatova që teknika legjislative lë shumë për të dëshiruar, akti nuk ka një rrjedhshmëri, megjithatë do t'i diskutojmë në vijim, kur të ngelemi në diskutimin e çdo pike të veçantë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit koleg! Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Në vijim të shqetësimeve që ngriti kolegu Çakaj, bie dakord me të. Më duhet të ritheksoj dhe njëherë që sot në tryezën ku jeni ulur ju, përfaqësues të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

administratës, prisnim që prezent të ishte këtu dhe të prezantonte aktin, për vetë rëndësinë që ka ky akt, si akti i cili do të mundësojë votimin nga jashtë të gjithë shtetasve shqiptarë që ndodhen dhe presin për herë të parë të jenë pjesë e këtij procesi, pra duhet të ishte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përzgjedhur të jetë hije në këtë proces ndoshta, por kjo nuk i shërben procesit, për më tepër po sjell gjithë këtë zvarritje, për të cilën ne kemi ngritur shqetësimin dy-tre muaj përpara dhe e kemi përsëritur, drejtuar atij, njëkohësisht dhe administratës, jo vetëm faktin që ku është paketa e akteve, në cilën fazë ndodhet, por në të njëjtën kohë edhe për shpejtimin e kësaj pakete, për hir të një vendimmarrje të konsoliduar dhe të sigurtë. Ende sot, të nderuar, ne nuk kemi dy akte të tjera, të cilat janë po aq të rëndësishme. Ndërkohë që data shënon 11 nëntor, data e fundit sipas nenit 24 të Kodit, pikës 5 të tij, të ndryshuar do të thotë që është afati përfundimtar i realizimit të gjithë procesit të vendimmarrjes nga ana jonë. Ju shkruajmë të nderuar anëtarë të administratës, nuk marrim asnjë përgjigje, kjo është përsëri e dhimbshme sepse i bie që për ne nuk jeni pjesë dhe hallkë asistuese apo ndihmëse, jeni pjesë apo hallkë asistuese vetëm në një drejtim, të një prej organeve dhe kjo është për të ardhur keq dhe lë shumë për të dëshiruar. Nuk e di se kush do të mbajë përgjegjësi për të gjithë këtë handikap të krijuar, apo që po i krijohet procesit, por di të them që në qoftë se ka ndonjë skenar pas kësaj, patjetër që do të jeni përgjegjës, në kuptimin administrativ por dhe përtej. Kështu që ju lutem, për kaq kohë sa kanë ngelur do të doja të njihesha si unë edhe kolegët padiskutim, me të gjithë aktet e mbetura që i shërbejnë këtij procesi. Po të shikosh edhe këtë draft të ardhur, domethënë në katër vite që kemi veprimtari, ushtrim veprimtarie në këtë institucion drafte të kësaj natyre nuk kanë ardhur ndonjëherë! Cilësia është tejet e dobët, fjalitë të keqformuara, fjali të cilat nuk na japin ne qartësinë se ku po shkojmë, jo më t'i japin qartësinë publikut apo grupeve të interesit që na ndjekin dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

monitorojnë këtë proces. Kështu që, përpos kësaj vështirësisë i shtohet edhe një vështirësi tjetër është ajo e mungesës së një demoje, se si keni menduar ta realizoni këtë proces. Aty për shembull, në një nga pikat thuhet një nga zarfet, tre nga zarfet, pse mos ta kishim këtë prezent, se si bëhet implementimi i kësaj gjëje, se si do jetë ky barkodi apo kodi unik, se cilat janë fleksibilitetet për t'i mundësuar zgjedhësit nga jashtë mundësimin e implementimit të këtij barkodi në zarf apo të tjerë elementë të cilët me të vërtetë bëjnë të ngrihen pikëpyetje, pikëçuditëse, edhe shumë dilema në draftin e këtij akti. Kështu që ju ftoj të ndërgjegjësoheni, për aq kohë sa ka mbetur, megjithëse padiskutim që vështirësia do të jetë sërish e jona dhe kjo absolutisht që do të ndikojë tek procesi dhe te vendimmarrja, minimalisht në afatet e vendimmarrjes. Por përgjegjësia në këtë rast do gjendet edhe se e kujt është. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Po, zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit! Që në fillim të herës edhe unë si anëtar i Komisionit Rregullator, madje që në seancën e parë që kemi bërë shqyrtimin e parë të aktit, për procedurat e regjistrimit, që në fillim, që pa filluar çështja e shqyrtimit në parim kam ngritur një kërkesë drejtuar administratës dhe Komisionerit për sjelljen e akteve në një kohë sa më të shpejtë për të pasur mundësinë e shqyrtimit brenda afateve ligjore. Kështu që pjesërisht jam dakord edhe me shqetësimin e ngritur nga kolegët për pjesën e mbetur të na vijmë sa më shpejt. Në vlerësimin tim është vetëm një akt që ka të bëjë me administrimin dhe vlerësimin e votave ndërsa për aktin tjetër për përfshirjen, besoj që kjo nuk përfshihet në pjesën e 90 ditëshit të Kodit Zgjedhor që na ka vendosur si afat sepse aty thotë vetëm për procedurat. Kështu që dhe unë do ta ripërsërisja edhe një herë po të njëjtën kërkesë që ju lutem na sillni sa më shpejt

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

dhe aktin apo akte të tjera që vlerësoni për t'i miratuar brenda këtij afati, duke qenë se mund të kenë ngelur dhe dy-tre ditë në lidhje me përfundimin e afatit. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Çështje të tjera jashtë rendit të ditës nuk kemi. Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”. Znj. Josifi do t’ju lutesha në mënyrë të përmbledhur të na prezantoni aktin.

**Znj. J. Josifi:** Ju faleminderit! Me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve paraqesim për shqyrtim, në vlerësimin dhe për miratimin tuaj projektvendimin “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”, bazuar në nenin 20, pika 1, të Kodit Zgjedhor si dhe ndryshimeve më të fundit të pësuara në ligj, përkatësisht neni 24, pika 5, neni 25/1, pika 1, 25/1, pika 2 e kështu me radhë në tërësi, pika 3, pika 4 të po të njëjtit nen, ku përcaktohet se Komisioni Rregullator me propozimin e Komisionerit përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij si dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit që është akti të cilin edhe ju sapo e përmendët që do të përgatitet dhe do t’ju përcillet sa më parë. Ndërkohë jemi në hapin paraardhës të këtij procesi për procedurat e votimit. Projektvendimi që keni përpara jush është i organizuar në pesë krerë. Së pari renditen parime të përgjithshme, praktikisht do të jenë shtyllat ku do të mbështetet procedura e votimit nga jashtë vendit, kemi renditur katër parime, atë të sigurisë së votës, fshehtësisë së votës, të transparencës dhe të diskrecionit. Në kreun e dytë kemi parashikuar rregulla të përgjithshme, që janë ato të përcaktuara në ligj sa i takon procesit të votimit nga jashtë vendit, dokumentacioni të votimit si dhe atij udhëzues që do të shkojë në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit. Në kreun tre

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

kemi rregulla të posaçme, për faza të ndryshme të administrimit të procesit që lidhen me dokumentacionin zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit, si përgatitet ky dokumentacion dhe çfarë përmban ai. Setin me dokumentacionin zgjedhor që i dërgohet këtij të fundit, në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij nënkreu. Dërgimi i dokumentacionit kemi parashtruar aty, të bëhet nëpërmjet një shërbimi postar i cili duhet të mundësojë gjurmimin e këtij materiali, për të cilin po ashtu edhe zgjedhësi do të njoftohet në PER. Në vijim të këtij kreu, përkatësisht është pjesa që përcakton rregulla të posaçme se si zgjedhësi e plotëson fletën e votimit dhe se si ai e dërgon mbrapsht dokumentacionin zgjedhor në KQZ. Përcaktohet sa vijon, pasi plotëson fletën e votimit zgjedhësi e vendos atë në zarfin e fletës së votimit dërguar nga KQZ, ku futet vetëm fleta e votimit dhe asnjë dokument tjetër. Praktikisht ky zarf i vogël, po e quajmë kështu për lehtësi të shprehurit, ku vendoset fleta duhet të mbyllet, ai vendoset në një zarf të jashtëm i cili po ashtu dërgohet nga KQZ, ku ngjitet ose atashohet një kod unik, që është ai i regjistrimit të këtij zgjedhësi të cilin e ka marrë me konfirmimin e regjistrimit të tij në platformën elektronike. Në vijimësi zgjedhësi të gjithë këtë paketë, po e quajmë kështu, e poston në adresën e cila do t'i njoftohet paraprakisht nga KQZ-ja. Kemi rekomanduar këtu gjithashtu përdorimin nga ana e zgjedhësit të një shërbimi postar i cili do të mundësojë gjurmimin e dërgesës, për informacion të tij, por edhe për hir të gjurmimit të të gjithë rrugëtimit që ky dokumentacion bën. Afatet janë ato të parashikuara në Kodin Zgjedhor, sa i takon mbërritjes së fletës së votimit ose të këtij dokumentacioni zgjedhor në tërësi, në Republikën e Shqipërisë. Në kreun katër kemi përcaktuar mënyrën e ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit të dërguar nga zgjedhësi deri në momentin që do të fillojë pastaj numërimi dhe vlerësimi i votave. Kreu pesë parashikon rregulla që lidhen me mbikqyrjen dhe monitorimin e procesit të votimit të shtetasve shqiptarë, për të siguruar transparencë dhe qasje të të gjithë palëve, në të gjithë hapat e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

përgatitjes së këtij procesi por edhe të zbatimit në praktikë të tij. Përkatësisht e drejtë që u njihet përfaqësuesve të partive politike, organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe zgjedhjeve, medias apo çdo pale tjetër me interes të ligjshëm në këtë proces. Kemi bërë një punë parapërgatitore për të kuptuar aspektet teknike të administrimit të këtij procesi, kemi identifikuar fillimisht operatorët e shërbimit postar që veprojnë brenda vendit, të licensuar, kemi zhvilluar një takim teknik me ta, ku kemi ftuar dhe përfaqësues të partive politike dhe kjo na ndihmoi për ta hartuar projektvendimin që keni sot për shqyrtim. Ky projektvendim është bashkërenduar gjithashtu me palët e interesuara, është publikuar për konsultim publik, ju është dërguar ju si Komision Rregullator, përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të organizatave, qofshin ato të diasporës apo organizatave brenda vendit. Bashkërendimin, reflektimet i keni të shtjelluara në relacionin që shoqëron projektvendimin. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Josifi! Kolegë fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit, dëshiron fjalën dikush? Zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Atëherë, unë e dëgjova me vëmendje relatimin e znj. Josifi dhe më tërhoqi vëmendjen relatimi se ky projektakt i është nënshtruar konsultimit publik. Mund ta di çfarë periudhe, që nga momenti i dërgimit ose publikimit ky projektakt i është nënshtruar konsultimit publik dhe kush ka dhënë ndihmë apo sugjerime, vërejtje, feedback, lidhur me këtë projektakt? Sa ka qëndruar për konsultim publik, dy ditë, tre ditë, katër ditë?

**Znj. J. Josifi:** Vetëm një moment, më lejoni të gjej datën e saktë. Atëherë është dërguar për konsultim publik në datën 4 nëntor, ka pasur afat për t'u dërguar

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

mendime deri në datën 7 nëntor, në orën 16.00. Në orën 17.00 po të datës 7 nëntor Komisioneri ka zhvilluar një takim konsultues online me organizata të diasporës dhe të shoqërisë civile vendase, përkatësisht pasditen e datës 7 nëntor, nga ora 17 deri në orën 19.30 me orën e Tiranës. Janë marrë mendime me shkrim edhe pas këtij momenti, përkatësisht në datën 8 nëntor në mëngjes, në këtë rast nga organizata KRIIK. Ndërkohë të gjitha mendimet e shprehura me shkrim apo edhe në takim janë të sqaruara, unë mund t'i kaloj pikë për pikë në relacion, pjesa e fundit, bashkërendimi i projektvendimit me palët e interesuara.

**Z. M. Çakaj:** Jo s'ka nevojë.

**Znj. J. Josifi:** Zyrtarisht...

**Z. M. Çakaj:** Një pyetje, në vijim të kësaj që sapo relatuat. Në datën 7 nëntor, në atë takim online nuk u pa e nevojshme fare, meqë ne kemi një praktikë, të paktën në aktin e kaluar, shumë të mirë që zhvilluam edhe ne një konsultim online si Komision Rregullator dhe besoj se i shërbeu procesit. Nuk u pa e nevojshme që të ishim dhe ne në atë takim konsultativ si anëtarë të Komisionit Rregullator?

**Znj. J. Josifi:** Ishte një takim konsultues për draftin, pra për projektvendimin që Komisioneri ka propozuar.

**Z. M. Çakaj:** Po, pra, aktin ju na e keni nisur dhe ne, në mos gaboj në datën 4 nëntor, njëkohësisht na e keni nisur dhe ne, të gjithë për një qëllim jemi, për kontributin e hartimit të një drafti sa më ligjor, sa më të thjeshtë, sa më të kuptueshëm. Kështu që nuk u vlerësua kjo?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Ne e kuptuam nga hera e fundit e takimit që ju kërkuat të zhvillonit.

**Z. M. Çakaj:** Po sepse e kërkuam të zhvillojmë sepse në të gjitha takimet konsultative që janë zhvilluar nga Komisioneri ne nuk kemi qenë asnjë moment prezent, thjesht jemi anashkaluar si Komision.

**Znj. J. Josifi:** Sepse lidhen me konsultimin e projektvendimit që Komisioneri propozon tek ju. Nëse ju dëshironi që të zhvillonit si Komision Rregullator takime konsultuese patjetër ne i lehtësojmë në të njëjtën mënyrë dhe sa më parë, siç bëmë edhe herën e fundit me kërkesën tuaj.

**Z. M. Çakaj:** Unë personalisht do të dëshiroja shumë për çdo akt ka nevojë.

**Znj. J. Josifi:** Patjetër! Të zhvillohen në të njëjtën kohë, pra konsultimi të jetë...

**Z. M. Çakaj:** Në të njëjtën kohë, ose të ishim prezent edhe për ekonomi të kohës, të ishim prezent dhe të rrihnim mendime, personalisht do doja, besoj do të ishin dakord dhe kolegët e tjerë.

**Znj. J. Josifi:** Dakord.

**Z. M. Çakaj:** Nejse, gjithsesi faleminderit!

**Znj. I.Nano:** Faleminderit z. Çakaj! Kemi diskutime të tjera në parim për projektvendimin? Jo. Nga subjektet, nga partitë politike? Jo. Kalojmë në votimin në

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

parim të projektvendimit “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s’ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Kalojmë në shqyrtimin e detajuar. Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh” e nenit 24, pika 5, e nenit 25/1 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi: Kreu I “Parime të përgjithshme”, do të më lejoni të lexoj me krerë dhe pastaj në qoftë se do të keni kolegë, por edhe përfaqësuesit e partive politike kërkesa për të ndërhyrë në pika të caktuara të krerëve, pasi të ketë mbaruar leximi i kreut përkatës, mund të merrni fjalën.

Kreu I “Parime të përgjithshme”, 1. “Parimi i sigurisë së votës. Siguria e votës është një element kyç i procesit zgjedhor që duhet të garantohet përmes mekanizmave ligjorë dhe administrativë që parandalojnë çdo manipulim apo ndërhyrje të paligjshme. 2. Parimi i fshehtësisë së votës. Vota e çdo zgjedhësi është e fshehtë dhe e paprekshme, asnjë palë e tretë nuk mund të ndërhyrë për të cënuar votën e zgjedhësit nga jashtë. 3. Parimi i transparencës. Rregullat për procedurat e votimit nga jashtë duhet të garantojnë auditim të plotë e pakufizim të procesit të votimit të zgjedhësve nga jashtë. 4. Parimi i diskrecionit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës”. Lidhur me Kreun I, “Parime të përgjithshme” kush ka diskutime kolegjë? Zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit Kryetare! Atëherë një pyetje për administratën, votimi nga jashtë bëhet me disa procedura apo me një procedurë?


**Znj. J. Josifi:** Nëse e keni fjalën për titullin e projektvendimit kemi përdorur numrin shumë të fjalës “procedurë” sepse në Kreun III ka disa procedura në kuptim të disa fazave të procesit. Pra ka një procedurë se si përgatitet dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit, si ai i dërgohet, si zgjedhësi voton dhe si e administrojmë në në KQZ pastaj këtë dokumentacion zgjedhor të ardhur deri në momentin kur të fillojë numërimi dhe vlerësimi i votës. Kjo është e vetmja arsye pse është në numrin shumë, kemi thënë procedurat, jo se ka disa procedura si votohet.

**Z. M. Çakaj:** Jam dakord, por ideja është ta bëjmë sa të thjeshtë për zgjedhësit. Atëherë ne po miratojmë disa rregulla, por për procedurën e votimit nga jashtë, pra ta bëjmë të thjeshtë se procedura e votimit nga jashtë është vetëm një, ndërsa kemi disa rregulla, kemi një tërësi, një mori rregullash për procedurën e votimit. Pra thjesht numri njëjës apo shumë, mos ta konfuzojmë atë proces. Po pse e ka ligji, një procedurë votimi.

**Znj. I. Nano:** Procedurat e detajuara thotë ligji, neni 24/5.

**Z. M. Çakaj:** Po pra po një procedurë ka.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj.H. Vukaj:** Procedurat e detajuara, kurse këtu kemi të bëjmë me miratimin e rregullave për procedurën e votimit.

**Z. M. Çakaj:** Ka një mori rregullash

**Znj. H. Vukaj:** Sepse po të kishim dy procedura votimi, pra një manuale dhe një elektronike.

**Z. M. Çakaj:** Mos ta konfuzojmë procesin,

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë do të kishim dy procedura, kurse këtu kemi vetëm një procedurë, kryhet përmes një platforme.

**Z. M. Çakaj:** Një procedurë kemi, jo ka disa rregulla, një mori rregullash po një procedurë votimi kemi. Kjo është ideja ta bëjmë sa më të thjeshtë procedurën e votimit nga jashtë.

**Znj. I. Nano:** Pyetja që kishit kalon në një propozim konkret?

**Z. M. Çakaj:** Po, thjesht titulli të ndryshojë, nga “procedurat” në “procedurën e votimit nga jashtë”. Pra jam shumë dakord që ka një mori rregullash të cilat do t’i detajojmë këtu po një procedurë votimi, për ta bërë sa më të thjeshtë për ata.

**Znj. I. Nano:** Dakord, kemi një propozim të z. Çakaj për titullin. Propozim për Kreun I kemi?

**Z. M. Çakaj:** Po. Kemi dhe për Kreun I.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Po, kush ka propozime?

**Z. M. Çakaj:** T'i bëj bashkë me këto?

**Znj. I. Nano:** T'i bëjmë bashkë dhe atëherë t'i kalojmë.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë unë propozoj që krahas parimeve të vendosura në Kreun I "Parime të përgjithshme", si pika 1 dhe pika 2, të vendosim dhe parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 45, pika 4 dhe konkretisht në pikën 1 të vendoset parimi i barazisë së votës, me formulimin si më poshtë: "Vota e shtetasve shqiptarë që votojnë jashtë vendit është e barabartë me votën e shtetasve shqiptarë që votojnë brenda vendit". Ky është një parim që në gjykimin dhe vlerësimin tim është i domosdoshëm dhe ky parim duhet të udhëheqi këtë akt. Pra, barazia e votës së shtetasve shqiptarë si me banim jashtë dhe me banim brenda, njësoj numërohet ajo, kanë të drejtë njësoj të vlerësohet, njësoj të japë efektin e saj. Krahas kësaj do të doja ta ngrini në nivel parimi dhe në pikën dy të vendosim parimin e lirisë së votës dhe ky propozim gjen mbështetje në nenin 45, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe formulimi është si më poshtë: "Shtetasit shqiptarë që votojnë jashtë vendit janë të lirë të zgjedhin sipas dëshirës dhe vlerësimit të tyre". Lidhur me pikën e parë që propozoj të bëhet pika 3, parimin e sigurisë së votës do të propozoja një riformulim, duke shtuar elementin e garancisë. Pra, propozimi im konkret është: "Parimi i garantimit dhe sigurisë së votës. Vota e zgjedhësve nga jashtë vendit është e sigurt dhe e garantuar. Garantimi dhe siguria e votës janë elementë thelbësorë në procesin zgjedhor. Këto elementë realizohen përmes respektimit të ligjit dhe instrumentave administrativo-ligjorë të kontrollit dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

kanë si qëllim të parandalojnë çdo pengim, manipulim apo ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e së drejtës së votimit nga jashtë”. Te pika 2 që bëhet pika 4, parimi i fshehtësisë së votës, thjesht një riformulim për t’i vënë theksin elementit të garantimit të votës. Kështu që paraprakisht vetëm këto, po nëse ka propozime të tjera nga kolegët.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Pra, kolegu Çakaj propozoi dhe riformuloi edhe parimin e sigurisë duke i shtuar mjetin e garantimit apo jo. Ndërkohë që tek parimi i fshehtësisë mund të riformulohet më mirë duke i rritur karakterin imperativ dhe mund të themi që vota e zgjedhësit nga jashtë është e fshehtë, pra të shtohet fjala “nga jashtë” pas zgjedhësi, “është e fshehtë dhe e paprekshme, asnjë palë e tretë nuk duhet dhe nuk mund” kjo është shtesa që propozoj “të ndërhyjë për të cënuar votën e zgjedhësit nga jashtë”. Tek parimi i transparencës, më tej, në qoftë se titulli do të mbetet “procedurën e votimit”, atëherë mund ta rregullojmë dhe këtu “rregullat për procedurën e votimit nga jashtë do të jenë baza për auditim të plotë, pakufizim, në çdo fazë”, meqenëse ne këtë propozim e miratuar në aktin kryesor, “të procesit të votimit të zgjedhësit nga jashtë”. Tek parimi i diskrecionit, meqenëse kolegu propozoi garantimin, mendoj që të forcohet pozita e sigurisë duke shtuar edhe mjetin e garantimit sepse jemi institucioni që duhet dhe kemi detyrimin ligjor të garantojmë në të njëjtën kohë, të sigurohet kjo votë si e drejtë kushtetuese. Pra të shtohet fjala “garantimin”, pas fjalës “me qëllim”. Pra, “me qëllim garantimin, sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë nga jashtë vendit”. “Të rritet objektiviteti i tyre dhe nivelet e kontrollit duke adresuar dhe zgjidhur situatat eventuale të paparashikuara”. Pra, ky

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

është kompozimi i parimit të fundit. Këto janë propozimet e mia për momentin.  
Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Unë kam vetëm një pyetje para se të kalojmë në votim që të qartësohem mbi propozimin tuaj. Tek parimi i transparencës ju folët për rregulla, për procedurën e votimit nga jashtë, “do të jenë baza për auditim të plotë dhe pakufizim në çdo fazë të procesit të votimit të zgjedhësve nga jashtë”. Tani, “në çdo fazë”, mos vallë nënkupton dhe fazën kur zgjedhësi është në shtëpi dhe po plotëson fletën e votimit? Si do ta, fazë e procesit është ajo.

**Znj. H. Vukaj:** Nëse ju e doni për transparencë për publikun se unë nuk mendoj që ju nuk e kuptoni. Domethënë e kuptoni mjaft mirë faktin që kjo fazat dhe “çdo fazë” ka të bëjë me procesin përtej nxitjes së manipulimit apo ndërhyrjes për manipulim. Pra, mbasi votuesi i ka futur, e ka ushtruar vullnetin e tij dhe e ka vendosur fletën e votimit në zarf, pra përtej këtij procesi.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Mirë atëherë kalojmë në votim. Së pari kemi ndryshimin e titullit. Fjala “procedurat”, propozohet të jetë “Për procedurën”.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s’ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

Kemi në Kreun I, ndryshimet e propozuara z. Çakaj propozoi si pikë të parë, parimin e barazisë së votës, si pikë të dytë parimin e lirisë së votës dhe si pikë të tretë

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

garantimin dhe sigurinë e votës sipas përmbajtjes që u lexua. Z. Çakaj jam korrekte me propozimet tuaja?

**Z. M. Çakaj:** Po, po korrekte e nderuar!

**Znj. I. Nano:** Kalojmë në votimin e propozimeve të kolegut Çakaj.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s'ka!

**Miratohet me 5 vota pro!**

Kalojmë tani tek propozimet e znj. Vukaj, tek parimi i fshehtësisë me shitesat që propozoi, pra “zgjedhësi nga jashtë” dhe “nuk duhet dhe nuk mund të ndërhyjë” në këtë parim. Tek parimi i transparencës është korigjuar dhe s’po e votojmë më fjala “procedurat”, me “procedurën”, se e votuam njëherë dhe është shtuar “në çdo fazë”. Te parimi i diskrecionit, pas fjalës “me qëllim” është shtuar fjala “garantimin” dhe në fjalinë e fundit “dhe të garantohet e drejta e votës nga jashtë, të rritet objektiviteti i tyre dhe nivelet e kontrollit duke adresuar dhe zgjidhur situata eventuale të paparashikuara”.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s'ka!

**Miratohet me 5 vota pro!**

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

Kalojmë në Kreun II. Nuk pyeta subjektet, nëse do të keni për të ndërhyrë ju lutem kërkonti fjalën. Atëherë, Kreu II “Rregulla të përgjithshme”, më duhet ta lexoj, ndjekim të njëjtën procedurë. Titulli i kreut “Rregulla të përgjithshme”, pika 1. “Të drejtën e votës nga jashtë vendit e ka çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, emri i të cilit gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë dhe që në PER ka ngarkuar një dokument identifikimi të vlefshëm para miratimit të kësaj liste. 2. Fleta e votimi nga jashtë vendit është për çdo zonë zgjedhore e njëjtë me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por me një element të veçantë dallues. 3. Fletët e votimit prodhohen për çdo zonë zgjedhore dhe numri i tyre është i barabartë me numrin e zgjedhësve në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë, duke i shtuar 2% për çdo zonë zgjedhore. Në rast se gjatë përgatitjes së dokumentacionit zgjedhor nga personeli përkatës i KQZ-së dëmtohet një fletë votimi ajo zëvendësohet me një fletë votimi tjetër nga kontigjenti rezervë prej 2%, me këtë rast nga ky personel mbahet një procesverbal i cili depozitohet menjëherë në protokollin e KQZ-së. 4. Fletët e votimit të papërdorura futen në një apo disa kuti, të cilat mbyllet me vula me kode sigurie. Procesverbali për mbylljen e kutisë/kutive depozitohet në protokollin e KQZ-së dhe kopje të tij me kërkesë marrin përfaqësuesit e partive politike në KQZ, si dhe vëzhguesit e akredituar në KQZ. Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit dhe dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga Kodi Zgjedhor për mbylljen e votimit, në qendrat e votimit.” Atëherë për Kreun II, kolegë, “Rregulla të përgjithshme”? Po.

**Znj. H. Vukaj:** Në pikën 2 që lexuat zonja Kryetare, “Fleta e votimit nga jashtë vendit është për çdo zonë zgjedhore e njëjtë me fletën e votimit që përdoret brenda

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe këtu jemi të gjithë dakord që jemi para parimit të barazisë, por pas presjes kemi një shtesë në këtë pikë “por një element të veçantë dallues”. Nga administrata, për hir të transparencës dhe për hir të mosthyerjes së parimit të barazisë do të doja të dija se me çfarë elementi dallues konkret kemi të bëjmë në këtë rast?

**Znj. J. Josifi:** Atëherë kemi marrë, përkatësisht pikën, fjalinë e dytë të pikës 2 të nenit 25/1 të Kodit Zgjedhor “Fleta e votimit është e njëjtë por me një element të veçantë dallues në fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”, që do të thotë ky element dallues do të përcaktohet praktikisht me akt nënligjor, në përmbajtjen e fletës së votimit ashtu sikundër miratohet përmbajtje e fletës së votimit brenda vendit, do të miratohet dhe përmbajtja e fletës së votimit jashtë vendit, por në këtë rast...

**Z. M. Çakaj:** Po pra, po pyetja, shumë qartë, ideja është të mos rrimë nivel, pa fyer askënd, as ne, as ju, të mos rrimë në nivel papagalli të Kodit Zgjedhor. Çështja është shumë e thjeshtë, elementi i veçantë dallues, patjetër e dimë shumë mirë, që e ka Kodi por ku konsiston, do të jetë ngjyra e ndryshme, do të ketë ndonjë shënim “fletë votimi për zgjedhësit nga jashtë vendit”, si? Nuk e keni identifikuar ende? Se jemi shumë dakord që në momentin, që do të prodhohen fletët e votimit patjetër atëherë do të materializohet dhe kjo. Sot, keni ndonjë ide?

**Znj. J. Josifi:** Jo.

**Z. M. Çakaj:** Qartë!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Pra mund të thuhej një element dallues që ka të bëjë me ngjyrën, me një element sigurie. Pra duhej diçka këtu, pikërisht në këtë pikë për të mos i dhënë premisën, se shiko është një gjë e fshehtë, që ne, ju s' do ta merrni vesh kurrë se çfarë është ajo, pra diçka duhet. Pavarësisht se Kodi e ka lënë shabllon, po ne nuk jemi për shabllonin, ne jemi për të zbërthyer shabllonin, për t'i dhënë shtetasve që do të votojnë nga jashtë garancinë që kjo fletë nuk do të survejohet, shikohet nga zarfat për shkak se na qenkërka e veçantë dhe do jetë dalluese, pra në kuptimin e vulnerabilitetit, e cënueshme si fletë.

**Znj. I. Nano:** Nëse mund të jap dhe unë mendimin tim për këtë çështje.

**Z. M. Çaka:** Sugjerim që kur të jetë momenti që të miratojmë elementët sipas parashikimit të Kodit Zgjedhor ta keni të qartësuar idenë.

**Znj. J. Josifi:** Nuk e menduam se është pjesë e këtij akti detajimi i elementit dallues se nuk lidhet me procedurën e votimit, pra përmbajtja e fletës nuk lidhet me procedurën, prandaj nuk është detajuar këtu.

**Z. M. Çakaj:** Shumë qartë. Ideja është këtu, pyetja konsistonte nëse do të kishit ndonjë ide paraprake se ku do të konsistonte elementi i veçantë dallues. Nuk e keni materializuar ende idenë.

**Znj. J. Josifi:** Jo, nuk e kemi.

**Z. M. Çakaj:** Qartë, dakord.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Dakord. Atëherë veç pyetjes nuk kishit ndonjë propozim për të ndërhyrë në kreun II. Kalojmë në votimin e kreut II.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s'ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Kreu III, “Rregulla të posaçme” dhe këtu kemi disa nënkrerë. Kështu që unë do të filloj me III/1 “Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit jashtë vendit”. 1. “Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë përmban: a) fletën e votimit, b) zarfin ku futet fleta e votimit, c) një dokument që përmban sqarime për zgjedhësin, për plotësimin e fletës së votimit, d) një dokument që përmban sqarime për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si dhe informacione të tjera zgjedhore nëse është rasti, e) zarfin e jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit. 2. Zarfi ku futet fleta e votimit është në përmasa dhe në ngjyrë të njëjtë për të gjithë zgjedhësit. 3. Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë përgatitet nga KQZ-ja”. Hapim diskutimin për pikë për pikë. Zoti Çaka, po.

**Z. D. Çaka:** Atëherë do të doja ta nisja nga kjo e fundit, kisha dy shqetësime, një në formë pyetje dhe një në formë propozimi. Ajo çfarë kisha në formë propozimi është që kur themi te pika III/1.1, e), themi “zarfin e jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit”, do të kisha një propozim që ne besoj jemi të qartë që ky është ai zarfi i ndërmjetëm midis zarfit të votimit dhe zarfit të shërbimit postar. Do të kisha një propozim që të kishim një sqarim këtu, të identifikonim më qartë se cili do të

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

ishte ky zarf, pra duke pasur dhe duke lexuar rrjedhën e procesit, ekzistencën dhe të një barkodi ose QR kodi që do të vendoset te ky zarf, do të kisha një propozim që këtu të bëhej një sqarim, pra në zarfin e jashtëm që do të përmbajë barkodin ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit. Pra të ishte, të identifikohet dhe të ishte edhe për zgjedhësin që ndodhet jashtë një konfondim se cili është ky zarf. Duke qenë se do paguhet nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra që për zgjedhësin të ishte e qartë që zarfi ku vendoset barkodi do të jetë zarf i dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që do të jetë i mbuluar nga ana e tij. Nuk e di nëse isha i qartë në shpjegim.

**Znj. I. Nano:** Unë kam një merak te kjo që sapo tha kolegu. Po të shohim më tej aktin parashikohet që kodin unik e vendos zgjedhësi, e printon dhe e vendos zgjedhësi dhe këtu jemi në pjesën çfarë dërgojmë ne. Mos vallë e paragjykojmë këtë proces, që në këtë moment. Pra për hir të transparencës kemi tre zarfa, kemi zarfin ku futet fleta e votimit, kemi këtë që e quajmë zarfi i jashtëm, kemi dhe zarfin të operatorit të shërbimit postar që do ta dërgojë zgjedhësi prej andej. Elementë të tjerë për këtë zarfin e jashtëm, pra në qoftë se ne që tani kemi paragjykuar një pikë të mëvonshme.

**Znj. J. Josifi:** Sqarimet për kreun III.3.

**Z. M. Çakaj:** Unë kisha, më fal, një pyetje. Atëherë me sa kuptohet nga gjithë akti, në rastin konkret jemi këtu, po më pas del dhe nëse lind nevoja do mund ta vendosim dhe këtu. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do t'i nisi zgjedhësit tre zarfe, apo dy zarfe? Jo tre zarfe, kështu nënkuptohet.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Do t'i nisi zgjedhësit dy zarfet, të cilat kur t'ia nisi do t'i vendosi vetëm brenda një zarfi.

**Z. M. Çakaj:** Po pra tre zarfe, zgjedhësit do t'i venë në një zarf të madh që quhet zarfi...

**Znj. J. Josifi:** I operatorit të shërbimit postar. Në këtë zarfin e madh do t'i shkojë ky zarfi i jashtëm.

**Z. M. Çakaj:** Me kodin unik dhe zarfi i vogël do të vendoset fleta, po tre zarfe.

**Znj. J. Josifi:** Po.

**Z. M. Çakaj:** Së pari, pra kjo të qartësohet nëse do të ishte e udhës ose nëse mund ta bëjmë më të thjeshtë. Së dyti tek pika c, dhe d, ajo çfarë në i dërgojmë zgjedhësit jo dokument që përmban, ne zgjedhësit i dërgojmë një informacion, material, udhëzues sepse nuk ka karakteristikat e termit dokument, i cili në kuptimin juridiko-ligjor konsiderohet një dokument. Kodi i Procedurave Administrative, parashikon disa elementë që një fletë të marrë, të quhet dokument, po kështu dhe Kodi i Procedurave Civile dhe Kodi Civil parashikon raste konkrete se kur do të konsiderohet një akt, një shkresë e thjeshtë, private ose shtetërore, kur merr formën e dokumentit.

**Znj. H. Vukaj:** I nderuar koleg, një shtesë të vogël në ndihmë të konstatimit tuaj. Le të na thotë administrata, renditja c dhe d, “një dokument që përmban sqarime”, “një dokument që përmban sqarime”, në të dyja rastet është dokument me vulë, firmë të KQZ-së?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Apo me karakter informues?

**Znj. J. Josifi:** Është me karakter informues.

**Znj. H. Vukaj:** Apo ilustrativ, udhëzues?

**Znj. J. Josifi:** Me karakter ilustrativ, po.

**Znj. H. Vukaj:** Është material udhëzues, ashtu sikundër do përdorni për zgjedhësit brenda vendit, materiale edukuese zgjedhore?

**Znj. J. Josifi:** Po.

**Z. M. Çakaj:** Materiale edukuese zgjedhore.

**Znj. J. Josifi:** Po.

**Z. M. Çakaj:** Ta riformulojmë.

**Znj. I. Nano:** Të mbërrijmë në propozimet konkrete. Sa i përket koleg, nëse më lejon lidhur me atë që ju pyetët për dy apo tre zarfe. Në fakt këtu jemi te pjesa e dokument zgjedhor dhe këto dy zarfe janë dokument zgjedhor dhe çfarë dërgohet materiale, fleta e votimit etj., etj. Zarfi i operatorit të shërbimit postar është po e them në thonjëza “ambalazhi” i këtij dokumentacioni zgjedhor, pra nuk mund të ta fusim këtu se nuk është dokumentacion zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Jam dakord për këtë gjë, po ideja është që të mos konfuzohet zgjedhësi nga jashtë kur ne themi në akt, që janë dokumentacioni zgjedhor përmban dy zarfe, zarfin e vogël sekret ku sekretohet vota dhe zarfin ku do të vendoset kodi unik dhe pastaj mbërrijnë tre zarfe, për qartësi.

**Znj. I. Nano:** Sqarohet më tej ajo, si dokumentacion zgjedhor ai nuk është.

**Znj. J. Josifi:** Prandaj thashë që ai...

**Z. M. Çakaj:** Dëshiroj të sqarohet sepse e patëm ne shumë të vështirë ta kuptonim këtë pjesë, nga mënyra se si ishte formuluar akti.

**Znj. J. Josifi:** Ne prandaj i kemi listuar pra kreu III.1 është thjesht, praktikisht një listë se çfarë i shkon zgjedhësit. Pra zgjedhësi nga ky set, nga kjo dërgesë që KQZ-ja i dërgon, dy zarfat do të përdori për qëllime të votimit të tij, pra zarfin e vogël se do të fusë fletën dhe zarfin e jashtëm. Patjetër që këto të dyja shkojnë me një mjet që në këtë rast është prapë një zarf, por ai këtë zarfin e shërbimit postar që ne i dërgojmë për ta arritur atë, atij nuk i hyn në punë as në praktikë. Prandaj nuk është listuar ky i jashtëmi fare aty.

**Znj. H. Vukaj:** Pikërisht të kërkonte sqarim sepse dhe zgjedhësi duhet të dijë se çfarë do bëjë me secilin zarf. Pra, kush ka prioritet nga këto tre zarfa fizikë. Në këtë kuadër unë do të vijoj me një pyetje sqaruese, tek pika d, ku thuhet “si dhe informacione të tjera zgjedhore nëse është rasti”, pra “dërgohen fillimisht sqarime, për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi te Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

Zgjedhjeve si dhe informacione të tjera zgjedhore nëse është rasti”. Kjo është disi selektive dhe e paqartë, pra çfarë janë këto “informacione të tjera sipas rastit”?

**Znj. J. Josifi:** Ne e kemi lënë thjesht të hapur nëse do të ketë ndonjë informacion të cilin nuk mund ta klasifikojmë si informacion për plotësimin e fletës së votimit apo atë për procedurat e dërgimit mbrapsht, psh. një informacion tjetër për zgjedhësin do të ishte ai që menjëherë sapo dërgesa juaj, pra seti që ju po dërgoni mbrapsht në KQZ do të mbërrijë, ju do të njoftoheni në PER. Pra informacione të tjera të karakterit informues. E kemi lënë thjesht të hapur mos ta kufizojmë në informacionin që mund të lindë nevoja nesër t’i dërgojmë por nuk kemi pasur ndërmend diçka konkrete.

**Z. M. Çakaj:** Ideja është që, jo shumë dakord.


**Znj. J. Josifi:** Mund ta përfshijmë dhe atë nevojën tjetër që mund të dalë gjatë rrugës edhe në pjesën d, ishte thjesht një për..

**Z. M. Çakaj:** Jo, dakord. Nëse bëhet fjalë për këtë gjë sillni informacione të tjera, të cilat rregullojnë procesin e votimit.

**Znj. J. Josifi:** Po pra, prandaj kemi thënë nëse është rasti, në nuk do të jetë ne nuk kemi qëllimin të dërgojmë as informacione shtesë pra më shumë seç duhet, as nëse është rasti, pra nëse do të lindë nevoja.

**Z. M. Çakaj:** Shumë dakord, thjesht ta përmbyllim, meqë ky është qëllimi si dhe informacione të tjera të cilat i shërbejnë zgjedhësit nga jashtë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Pra nëse vendosim “si dhe informacione të tjera” i bie që duhet t’i çosh, gjithsesi.

**Z. M. Çakaj:** Jo, jo në...

**Znj. I. Nano:** Kemi shtuar dhe “të tjera”.

**Z. M. Çakaj:**... në materialin, udhëzuesin që ne do t’i dërgojmë zgjedhësit ne do e dërgojmë mënyrën për plotësimin e fletës, sqarime të ndryshme për procedurën e dërgimit pas të zarfit dhe fletën e votimit si dhe sipas rastit informacione të cilat kanë të bëjnë po me këtë proces, jo sipas rastit.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Nuk janë dokumentacion tjetër po informacione.

**Z. M. Çakaj:** Jo, jo informacion këtu.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Znj. H. Vukaj:** Thjesht të mbyllet tek zgjedhori.

**Z. M. Çakaj:** Që lidhen me zgjedhësit.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Kolegu, po përfaqësuesi i Partisë së Lirisë.

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL:** Thjesht doja të pyesja a kanë elementë sigurie apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Po zonja Josifi!

**Znj. J. Josifi:** Atëherë është përcaktuar edhe në këtë akt që zarfet do të jenë të standartizuara, por nuk e di me çfarë i referoheni element sigurie. Në takimin që ne patëm, të nivelit teknik me operatorët e shërbimeve postare, praktikisht këto dy zarfe, pra zarfi i vogël ku do të fusë zgjedhësi fletën e votimit dhe zarfi i jashtëm specifikon, mund t'i përcaktohen specifikime teknike sido që të jetë, të vlerësohet e nevojshme. Ka ose zarfa me fletë të thjeshtë na bënë me dije, pra si kjo letra A4, ashtu sikundër ka dhe zarfa që janë të një materiali specifik, pak më të trashë, të cilët nuk dëmtohen nga gërvishtjet apo lagia me lëngje, aq kollaj. Këto dy versionet e zarfeve që përdoren kudo, në nivel ndërkombëtar për shërbimet, nuk mund të kemi një lloj materiali tjetër.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Kalojmë në formulimin e propozimeve konkrete. Atëherë z. Çakaj, ju kishit pikën c dhe d, dëshironit ta bashkonit në një?

**Z. M. Çakaj:** Po ta bashkoj dhe ta riformulohet, duke qenë se nuk përmban karakteristikat e dokumentit ky informacioni dhe “material udhëzues që përmban sqarime për zgjedhësin, për plotësimin e fletës së votimit, sqarime për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi te KQZ, si dhe informacione të tjera që lidhen për procesin e votimit, që lidhen me procesin e votimit”.

**Znj. I. Nano:** “Informacione të tjera”.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** “Si dhe informacione të tjera që lidhen me procesin e votimit”, po kjo është gjithëpërfshirëse.

**Znj. H. Vukaj:** Nëse lind nevoja për një informacion shtesë që do t’ua çosh të gjithëve.

**Z. M. Çakaj:** Pra te ky informacion do të kemi, të dy në mënyrën e votimit, mënyrën e kthimit mbrapsht si dhe informacione sipas rastit.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Kalojmë në votimin e propozimit të kolegut Çakaj.

***Kush është dakord?***


***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s’ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Kalojmë në kreun III, nënkreu III/2 “Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor te zgjedhësi” 1. “Dokumentacioni zgjedhor i përgatitur sipas seksionit III.1 i dërgohet zgjedhësit nga jashtë në mënyrë individuale. 2. Dokumentacioni zgjedhor për votimin nga jashtë i dërgohet zgjedhësit në adresën e deklaruar në PER nga vetë zgjedhësi. 3. Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor bëhet nëpërmjet një shërbimi postar ekspres që mundëson gjurmimin e dërgesës. 4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofertues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, të cilët kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë. Zgjedhja e këtij operatori realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik. 5.

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

Operatori i përzgjedhur i shërbimit postar ka detyrimin për raportim në mënyrë periodike mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor. Nëse operatori i shërbimit postar nuk ka mundur të dorëzojë te zgjedhësi dokumentacionin zgjedhor, atëherë ky operator ka detyrimin të njoftojë menjëherë KQZ-në dhe t'i dorëzojë këtij të fundit dokumentacionin zgjedhor përkatës". Fillojmë me diskutimet, unë personalisht kam një propozim për këtë kre, pastaj dhe kolegët. Pika 4 mendoj që është gjithashtu një përsëritje e një dispozite të ligjit dhe nuk ka lidhje me procedurën e votimit, po ka lidhje me procedura administrative që duhet të ndërmarë KQZ-ja në çdo rast për ta mundësuar, kështu që unë propozoj që pika 4 të hiqet, të mos votohet. Propozime të tjera? Zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Në pikën 5 kam një propozim për hir të rëndësisë dhe sigurisë që duhet t'i japim procesit. "Operatori i përzgjedhur i shërbimit postar ka detyrimin për raportimin ditor mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor", ndërkohë fjala ka qenë "në mënyrë periodike", pra mënyra se si raportohet ka qenë periodike unë propozoj të bëhet ditore.

**Znj. I. Nano:** Në mënyrë periodike ditore?

**Znj. H. Vukaj:** Dakord. Në mënyrë periodike ditore mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor, nëse operatori i shërbimit postar nuk ka mundur të dorëzojë tek zgjedhësi dokumentacionin zgjedhor atëherë ky operator ka detyrimin të njoftojë menjëherë KQZ-në dhe t'i dorëzojë këtij të fundit dokumentacionin zgjedhor përkatës.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Të bëj një pyetje te kjo pjesa zonja Josifi bëhet fjalë që t'ia dorëzojë prapë KQZ-së, pra “ky operator ka detyrimin të njoftojë menjëherë KQZ-në dhe t'i dorëzojë këtij të fundit, KQZ-së”.

**Znj. J. Josifi:** Po, Komisioni, prandaj kemi vënë “këtij të fundit”.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Znj. H. Vukaj:** Pra komplet zarfin e padërguar?

**Znj. J. Josifi:** Zarfin që nuk e ka arritur.

**Znj. I. Nano:** Zarfin e zgjedhësit.

**Znj. H. Vukaj:** Zarfin e padorëzuar?

**Znj. J. Josifi:** Po dhe praktikisht ajo ka një fletë, pra ka dokumentacion zgjedhor brenda, mos ta mbajë, ta hedhë.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë duhet “zarfin me dokumentacionin zgjedhor”.

**Znj. I. Nano:** “Të njoftojë dhe t'i kthejë KQZ-së”...Kthim është në fakt, t'ia dorëzojë zgjedhësit ndaj dhe unë kisha këtë pyetje. Pra në formulim, atëherë “ky operator ka detyrimin të njoftojë menjëherë dhe t'i dorëzojë KQZ-së dokumentacionin zgjedhor përkatës”. Se “këtij të fundit” duket sikur ngatërrohej. Atëherë kemi një propozim

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

për të hequr pikën 4, kemi propozimin që znj. Vukaj tha “në mënyrë periodike ditore”.

**Znj. H. Vukaj:** A duhet që në momentin e kthimit operatori të japë edhe justifikimin përse nuk u dorëzua?

**Znj. I. Nano:** Në fakt operatorët postarë në aq sa kemi pyetur kanë procedurat e dërgimit, thirrjes periodike...

**Znj. H. Vukaj:** Pra nuk u gjet adresa, nuk u ? Çfarë?

**Znj. J. Josifi:** Po, kjo është procedurë standarde.

**Znj. H. Vukaj:** Zarfi u kthye mbrapa.

**Znj. J. Josifi:** Kjo ishte procedurë standarde për të gjithë operatorët për çfarëdo lloj dërgese, dokumentimi i faktit që ajo uk mbërriti në destinacionin final, pra tek personi i synuar.

**Znj. H. Vukaj:** Procedurë standarde, patjetër.

**Znj. J. Josifi:** Po pra ka një dokumentim.

**Znj. I. Nano:** Pra, te pika 5 kemi në mënyrë periodike ditore dhe tek fundi i fjalisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë, t’i dorëzojë KQZ-së dokumentacionin zgjedhor, t’i kthejë thamë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

*Znj. H. Vukaj: T'i kthejë KQZ-së.*

*Znj. I. Nano: T'i kthejë KQZ-së. Atëherë votojmë propozimin e parë për pikën 4 për t'u hequr.*

*Kush është dakord?*

*Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

*Kundër: s'ka!*

*Miratohet me 5 vota pro!*

Pika 5, me dy propozime për riformulimin shtesën që propozoi znj. Vukaj dhe këtë ndërhyrjen e fundit që unë bëra.

*Kush është dakord?*

*Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

*Kundër: s'ka!*

*Miratohet me 5 vota pro!*

Kalojmë në seksionin III/3 "Ruajtja dhe administrimi, votimi dhe dërgimi i dokumentacionit zgjedhor në KQZ nga zgjedhësi", "1.Zgjedhësit që i ka mbërritur dokumentacioni zgjedhor nga KQZ, plotëson fletën e votimit duke bërë shënimin përkatës sipas udhëzimeve të dërguara nga ky institucion. Plotësimi i fletës së votimit bëhet në mënyrë individuale. 2. Pasi plotëson fletën e votimit zgjedhësi e vendos atë në zarfin e fletës së votimit së dërguar nga KQZ. Në zarfin e fletës së votimit vendoset, futet vetëm fleta e votimit dhe asnjë dokument tjetër. 3. Nuk

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

lejohej asnjë lloj shënimi mbi zarfin e fletës së votimit. 4. Zarfi i fletës së votimit i cili përmban vetëm fletën e votimit vendoset në zarfin e jashtëm të dërguar zgjedhësi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të kreut III/1”. Duhet ta harmonizojmë seksion, jo kreu, këtë. Tani III është kreu, III/1 është seksioni. “Mbi këtë zarf zgjedhësi duhet të vendosë, të ngjisë kodin unik të regjistrimit të tij në PER, të cilin ai e printon nga kjo plaformë. Kodi unik bëhet i disponueshëm nga PER për zgjedhësit nga jashtë vendit, pasi KQZ ka nisur procesin e dërgimit të dokumentacionit zgjedhor tek zgjedhësi. Kodi unik i zgjedhësit gjenerohet automatikisht nga PER dhe përmban emër, mbiemër të zgjedhësit, shtetin ku ka kërkuar t’i dërgohet fleta e votimit si dhe qarkun ku ka Regjistrin e Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë. Kodi unik i zgjedhësit është gjithashtu i pasqyruar në formën e një barkod ose QR kod. 5. Zarfi i jashtëm mbi të cilin është vendosur kodi unik i zgjedhësit i cili ka brenda zarfin që përmban fletën e votimit futet në zarfin e operatorit të shërbimit postar dhe postohet në adresën e KQZ-së. 6. Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor nga zgjedhësi për në KQZ rekomandohet të bëhet nëpërmjet një shërbimi postar i cili mundëson gjurmimin e dërgesës. Zgjedhësi duhet të kujdeset që dërgimi i dokumentacionit zgjedhor për në KQZ të bëhet brenda një afati i cili mundëson mbërritjen e tij në Republikën e Shqipërisë brenda orës 19.00, të ditës së zgjedhjeve”. Kemi diskutime për këtë seksion? Për këtë nënkre? Zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, atëherë përpara se të diskutojmë për diçka, lidhur me pikën 4, ku nga ana e administratës është parashikuar, që në zarfin e fletës së votimit, pra në materialin zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit, në momentin që KQZ ka nisur procesin e dërgimit të dokumentacionit zgjedhor, nëse e kam kuptuar drejt atëherë zgjedhësit në PER, i cili tashmë ndodhet në listën e zgjedhësve, në listën përfundimtare të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

zgjedhësve do t'i shfaqet një kod unik dhe do të duhet ta printojë këtë kod dhe në dërgimin mbrapsht të dokumentacionit bashkë me fletën e votimit, ta ngjisi. Së pari a është e mundur teknikisht që këtë kod ta printojë KQZ dhe në dërgimin e materialit zgjedhor ta nisi së bashku me kodin, në një format stiker dhe për thjeshtëzuar procesin sepse ndoshta dikush mund të duket kështu një arsye banale por mund mos të ketë dhe printer. Pra procesi ditor i shtetasit shqiptar, i emigrantit shqiptar është i ngarkuar në mënyrë të tillë që do të duhet t'i shtohet një hallkë për procesin e printimit dhe pastaj për procesin e ngjitjes se disa mund ta ngjisin me vinovil, disa mund ta ngjisin me material i cili mund të shkëputet. Çështja është a mos është më i thjeshtë procesi, pra ta prodhojmë ne dhe t'ia dërgojmë nëse nuk cënon procesin e fshehtësisë së votës? Nëse implikon diçka tjetër do të doja të isha më i qartë.

**Znj. J. Josifi:** Më lejoni, thjesht për të sqaruar fillimin e fjalisë suaj të parë. Ky kod nuk ngjitet as nuk vendoset në zarfin e vogël ku është fleta e votimit, po flasim për zarfin e jashtëm.

**Z. M. Çakaj:** Po flasim për zarfin e mesëm, po patjetër.

**Znj. J. Josifi:** Zarfi i jashtëm, thjesht për të t'ju shpjeguar. Sigurisht që teknikisht mundet ta bëjë KQZ këtë, mund të ketë kodin, mund ta printojë në çfarëdo lloj forme, stiker pra me ngjitje ose pa ngjitje, nuk është kjo çështja, patjetër që mund ta bëjë. Ne e kemi menduar këtë kod unik dhe të futurit në zarfin e jashtëm si një element, pra në kthim, si një element garancie, për t'u siguruar që seti që do të na vijë mbrapsht në KQZ, ka ardhur vërtet mbrapsht nga ai zgjedhës. Pra është një lloj si një aplikim që ne bëjmë si qytetarë për çfarëdo lloj shërbimi në sektor publik apo privat. Unë kam një kod unik timin që më identifikon mua, kërkesën time ose shërbimin që

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

unë po marr. Këtë kod unik e disponoj unë, pra kjo i shkon në profilin e tij çdo zgjedhësi. Ne e kemi lënë që këtë veprim ta bëjë pikërisht zgjedhësi, për t'u siguruar që kur të na vijë mbrapsht nuk e bën dikush tjetër. Pra ne vërtet mund ta nisim bashkë me kodin unik të zgjedhësit dhe ta përgatisim secilin set në mënyrë, të veçantë për secilin zgjedhës.

**Z. M. Çakaj:** Të individualizuar, po jam shumë dakord me këtë gjë.

**Znj. J. Josifi:** Ne e kemi bërë këtë sepse supozoni për një moment që ne nuk do të kishim këtë zarfin e dytë, këtë zarfin e jashtëm me këtë kodin unik të zgjedhësit, atëherë mund të kishim vetëm zarfin e vogël me fletët brenda i mbyllur, të cilin zgjedhësi do ta fuste në këtë zarfin e operatorit, shërbimit postar, një zarf i çfarëdoshëm ku ai do të vendoste adresën e dërguesit që është ai dhe adresën e marrësit, që është KQZ-ja në këtë rast. Nëse do të mbeteshim vetëm këtu, kush na garanton që këtë set e dërgoi pikërisht Jona, e postoi Jona, kush na e garanton këtë, thjesht, zarfi i jashtëm, kod dërguesi është Jona?

**Z. M. Çakaj:** Ja ta them unë kush ta garanton, atëherë ju praktikisht këtë proces mund ta zgjidhni nëpërmjet PER-it sepse ju ndërveproni me zgjedhësin, pra nuk është se zgjedhësit i erdhi zarfi dhe do të ketë mundësi manipulimi. Procesi i votimit nuk lind dhe nuk mbaron në momentin që vjen zarfi, plotëson fletën e votimit dhe e dërgon më pas, ndërkohë procesi lind dhe normalisht është dinamik që në momentin që zgjedhësi paraqet kërkesën në PER për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve, një. Së dyti ngarkon dokumentacionin qoftë për adresën, qoftë për dokument të vlefshëm identifikimi tashmë, në mënyrë që ai të votojë sipas procedurave që ne kemi miratuar dhe që parashikon, të paktën deri më sot, neni 105 i Kodit Zgjedhor. Së treti nga

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

periodha 68 ditë deri në 63 ditë nga lista paraprake zgjedhësi e ka fituar të drejtën 100% sepse ka kaluar te lista përfundimtare, pra ka një proces ndërveprimi interaktiv midis zgjedhësit nga jashtë dhe KQZ-së dhe automatikisht KQZ-ja ka krijuar bindjen nëpërmjet gjithë këtij procesi që po, ky është zgjedhësi, ky është i regjistruar në përputhje me Kodin Zgjedhor, me aktet me karakter rregullator, që ka miratuar KQZ-ja dhe unë këtij zgjedhësi do t'i dërgoj dokumentacionin zgjedhor së bashku me fletën e votimit dhe për thjeshtësi po ia printoj këtë dhe vetëm ta ngjisi dhe te informacioni të ishte kjo. Pikërisht sepse ka minimalisht dy zarfe, në fakt janë tre, zarfi i madh që bën vetëm shërbimin e transportit, zarfi me kodin unik që provon që i ka vajtur materiali dhe e ka sjellë materialin dhe zarfi i vogël që është i shkëputur dhe në procedurën tjetër besoj do bëjmë dhe këtë ndarje, në mënyrë që të ruhet parimi i fshehtësisë së votës. Unë besoj se është e mundur, kështu që do ta vlerësoja nëse kolegët do ta shikonin me këtë sy. Nuk mund të them dot për kostot se sa do të implikojë KQZ-në, nuk besoj se do të jenë shumë, nuk mund të them, por në funksion të procesit të thjeshtëzimit të procesit, të votimit nga jashtë, do të propozoja që këtë formulim, pra kodin unik ta printonte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në format stiker dhe t'ia dërgonin te zarfi i mesëm. Unë jam i hapur dhe për diskutime.

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje sërish, a mendoni se të gjithë emigrantët kanë mundësinë që ta printojnë këtë kod unik dhe në të njëjtën kohë a përputhet kjo me atë që ne miratuar më herët, parimin e lehtësisë? Kam përshtypjen se bie ndesh dhe krijon një lloj vështirësie për realizimin e së drejtës së votës sepse atyre që ne do t'i konsiderojmë, pra KQZ-ja do t'i konsiderojë zgjedhës, nga njëra anë i krijojmë mundësinë që të kenë lehtësira, procedura të lehta, të thjeshta dhe në këtë moment këto procese po implikohen ndoshta me shtesa të panevojshme të cilat për sa dëgjuam mund t'i bëjë dhe KQZ-ja. Ju thatë që ju keni merakun, ose keni menduar

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

që ky vëniea detyrë zgjedhësit që të printojë këtë, rrit elementët e sigurisë. Ku e shikoni ju këtë pjesën e ndërhyrjes nga të tretët, të riskut, për të ndërhyrë të tretët nga KQZ-ja, operatorët që do të punojnë këtu, nga KQZ-ja, rrugës për të shkuar zarfi apo atje ku kanë vendndodhjen zgjedhësit, ku e shikoni këtë element të riskut?

**Znj. J. Josifi:** Ne e kërkuam thjesht si një garanci shtesë për siguruar që dërguesi është ai që është. Për ne është shumë e thjeshtë ta bëjmë ne këtë gjë, ta bëjmë ne kodin, ta përgatisim zarfin, nuk kemi asnjë problem me këtë. Regjistrimi tashmë sipas vendimit tuaj do të ndodhë në PER apo do të bëhet në mënyrë individuale, fakti që aksesit në PER është i sigurtë sepse përcaktuam, i sigurtë në kuptimin e vërtetësisë së identitetit për tek, vërtetimit të identitetit të zgjedhësit sepse kemi përcaktuar disa faktorë autentifikimi, qoftë për të hyrë, qoftë për t'u regjistruar, duke ia çuar këtë kod unik në profilin e tij në PER, të cilin e akseson ai dhe vetëm ai sepse siç thamë ai hyn me numër personal, fjalëkalim, pastaj atij i verifikohen të dhënat, ndërkohë del edhe me fytyrë përpara platformës ne kështu sigurohemi që edhe në dërgimin mbrapsht për tek ne këtë veprim, pra këtë dërgim mbrapsht, fletën e votimit të futur në zarfin e vogël të mbyllur dhe të përgatitur setin dhe të dërguar në KQZ e ka bërë ai dhe vetëm ai dhe ndërkohë këtë dërgesë mbrapsht nuk e ka bërë në emër të tij, një mik, bashkëshort, bashkëshortja, motra, vëllai, vetëm për këtë e kemi bërë. E kemi bërë për element shtesë në kuptim të verifikimit të identitetit në një farë mënyre, pra të dërguesit, thjesht dhe vetëm për këtë. Nuk na kushton asgjë ta bëjmë ne këtë gjë.

**Z. M. Çakaj:** Më fal, kam një pyetje, çfarë ndodh...

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** A mundet të flas se jam e lidhur online, ta sqaroj këtë proces?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Kush është?

**Znj. H. Vukaj:** Mund të prezantohet zonja?

**Z. M. Çakaj:** Ja një sekond të lutem, të mbarojmë ne, pastaj jeni e lirë dhe ju se e kisha në vijim të procesit.

**Znj. I. Nano:** Të mbarojë z.Çakaj. Cila zonjë është?

**Z. M. Çakaj:** Një sekond të lutem.

**Znj. I. Nano:** Të mbarojë z. Çakaj, pastaj do të vijojë kush e ka kërkuar fjalën.

**Z. M. Çakaj:** Çfarë ndodh në rast se në zarfin me materialet zgjedhore, së bashku me fletën e votimit nuk është përfshirë kodi unik? Me hipotezën që e miratojmë kështu aktin, nuk ndodhet kodi unik, çfarë ndodh me këtë zarf, me këtë fletë votimi? Nuk ndodhet kodi unik.

**Znj. J. Josifi:** Në varësi se si do të jetë vendimmarrja juaj sot.

**Z. M. Çakaj:** Supozojmë se ne e miratojmë kështu siç e ka propozuar Komisioneri këtë, por ndodhemi përpara një situate që për një ose disa arsye objektive zgjedhësi nuk e ka, i është dëmtuar, nuk e ka futur atë, nuk e ka printuar dot, e ka shënuar me dorë kodin unik, çfarë ndodh? Se kjo lë hapësirë për shumë variante, në raport me atë se çfarë mund të bëjë KQZ, uniformitetin, stikerin.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Atëherë se ç'ndodh në këtë rast është e përcaktuar në seksionin III/4, pika 14, të këtij projektvendimi.

**Z. M. Çakaj:** Po e kam parë, çfarë ndodh? Ndahen mënjane këto, po çfarë ndodh më pas? Çfarë ndodh me këtë zarf, me këtë votë?

**Znj. J. Josifi:** Çfarë ndodh më pas? Do të duhet ta shqyrtojmë në aktin e radhës, duhet ta konsiderojmë aty, ky është një element garancie...

**Z. M. Çakaj:** Po prandaj do duhet të kishim.

**Znj. J. Josifi:** ...që i takon procedurës së votimit, nëse vendimmarrja juaj do të jetë, që kështu do të jetë, atëherë patjetër do të mendojmë dhe do të draftojmë një mekanizëm, e pari kontrolli që të verifikojmë që sasia e zarfave të ardhur, pra këtyre zarfave me kode unike përputhet edhe me sasinë e zarfave të vegjël, që janë, ku janë votat brenda. Pra një kontroll i dyfishtë në kuptimin sasior dhe pastaj do të vendosen se si do të jetë vlerësimi i votës që është element i aktit të radhës, por gjithsesi vlerësimi i fletës së votimit është i caktuar në Kod, kjo nuk lidhet me vlerësimin e fletës së votimit, ne jemi thjesht në administrimin e dokumentacionit zgjedhor, pra të dërgesës.

**Z. M. Çakaj:** Jo nuk është kështu.

**Znj. J. Josifi:** Në këtë moment po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Jo nuk është kështu të lutem!

**Znj. J. Josifi:** Si është?


**Z. M. Çakaj:** Së pari ne s'e kemi aktin, së dyti në mënyrë që të administrojmë apo jo votën, në mënyrë që ta kategorizojmë te kutia e votave të cilat do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit, të numërimit dhe vlefshmërisë së tyre do të duhet që zarfet të cilat kanë sjellë votën të kenë disa elementë të cilët ne këtu po i miratojmë. Tani përpara se të kalojmë, pra mungesa e këtij kodi unik ose mungesa e futjes së kodit unik a cënon vlefshmërinë e votës? Unë mendoj që jo!

**Znj. J. Josifi:** Jo dhe unë kështu mendoj, por nuk është objekt i këtij akti, nuk është objekt i këtij akti.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë prandaj kemi kërkuar që në krye të herës që të kishim gjithë aktet dhe të kishim një rrjedhë të të gjithë procesit çfarë do të ndodhi së pari. Së dyti, atëherë nëse kemi të njëjtin vlerësim që kjo, mungesa e kësaj nuk e cënon vlefshmërinë e votës dhe nëse është e mundur teknikisht të bëhet nga KQZ-ja, unë do të propozoja që kodin unik ta printonte në një stiker dhe ta bënte uniform Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pavarësisht se mund të shtojë pak burokracinë, por thjeshton procesin e zgjedhësit, nga ana tjetër për sa kohë nuk cënon as fshehtësinë, as vlefshmërinë e votës që do të duhet ta miratojmë në aktet e mëpasshme unë propozoj që këtë proces ta bëjë KQZ-ja.

**Znj. I. Nano:** Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Personalisht jam dakord me propozimin e kolegut, ndoqa me vëmendje të gjithë logjikën e përdorur dhe sqarimet e administratës dhe të kolegut njëkohësisht dhe me sa kuptova kodi unik nuk ka rëndësi për efektin votë por është thjesht dhe vetëm për të identifikuar më mirë që ky ishte, pra votuesi sepse zgjedhës ti e ke identifikuar dhe e ke bërë crosscheck që në momentin që ai është shfaqur në platformën PER. Pra, për sa kohë ky kod unik nuk ka rëndësi në mënyrë absolute për ushtrimin e së drejtës së votës, atëherë ky kod unik i shtohet përkundrazi garancia kur ti me duart e tua, KQZ, ia çon në adresë zgjedhësit dhe kjo bën dhe atë tjetrën që ky kod unik me elementët tuaj të sigurisë që mund t'i vendosni. Mund të vendosni elementë sigurie dhe në prodhimin e këtij kodi, nuk mund të prodhohet nga të tretë, të cilët do të tentonin që ta kishin uzurpuar këtë votues, këtë zgjedhës. Pra, do të ishte një element tjetër sigurie, pra çuarja në formën e stikerit, bërja gati atij votuesit për ta implementuar si pjesë të paketës së dokumentacionit.

**Z. M. Çakaj:** Madje mund të shtoj dhe një element shtesë që ashtu siç e kishit parashikuar ta printonin kodin unik, bëni njëkohësisht nëpërmjet platformës që i dërgoni një mesazh aty, por jo ta printojë. Atë çfarë i dërgoni mesazh, do ia printoni ju.

**Znj. I. Nano:** Nuk e di kush ndërhyri qëparë online. Nëse e mundësoni lidhjen atëherë, kam përshtypjen që nuk ishte...

**Znj. J. Josifi:** Me sa lexoj unë këtu nga ekrani është zonja Smorgrav.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Po ju dëgjojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:* Faleminderit për fjalën, doja vetëm të sqaroja...

*Znj. I. Nano:* Vetëm një moment të lutem. Teknikisht jemi në rregull? Mund të vijoni.

*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:* Më dëgjoni?

*Znj. I. Nano:* Po ju dëgjojmë.

*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:* Kjo prodhim i kodit paraprak i cili ka të kriptuar të gjithë identitetin e votuesit, duke pasur parasysh që do të vijë me zarf bashkë me votën që votuesi pastaj do ta hedhë vetë përbën një rrezik. Ndërsa fakti që vetë votuesi do të detyrohet të futet në PER përmes identitetit dhe njohjes së fytyrës, pra ka ato tre proceset e kryerjes është një farë simulimi i sikur të votosh në një qendër votimi, pra ti shkon vetë, tregon kartën e identitetit dhe merr fletën e votimit, voton. Prandaj them që është e rrezikshme që ky kod të jetë i para printuar dhe të niset bashkë me votën, e para sepse çënon pikërisht këtë garanci nëse do të jetë vërtet votuesi vetë që do ta çojë atë zarf dhe zarfet mund të çohen në një drejtim tjetër dhe prandaj të ketë votime në emër të disa zgjedhësve që ndoshta nuk e kanë dhënë votën e tyre dhe e dyta nuk e garanton votuesin për fshehtësinë e votës. Pra për identitetin dhe fshehtësinë e votës dhe ky ka qenë një propozim që ne kemi kohë si diasporë, ne “Diaspora për Shqipërinë e lirë” dhe bashkë e kemi diskutuar. Kemi zgjedhur formatin, një model i ngjashëm siç e ka Kosova, vetëm se Kosova votuesi jep kartën e identitetit për të certifikuar që ky është vetë që ka votuar, ndërsa në rastin konkret u gjet një zgjidhje më e sigurt, me enkriptimin e të dhënave përmes

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

një kodi, QR kod, apo një kod unik. Nuk e di nëse isha e qartë sepse kam një problem me fytin, por unë do të thoja që kjo do të çënojë në qoftë se bëhet e para printuar, mund të sjellë abuzime në shumë raste të tjera.

**Z. M. Çakaj:** Zonja Smorgrav, a mund të, se edhe nga administrata këtu...

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** Ju mund të diskutoni.

**Z. M. Çakaj:** Meqë ju paskeni identifikuar rreziqe, edhe nga administrata potencialisht mund të identifikohen rreziqe, a mund të kemi një rast, një? Cili do të ishte një rrezik, një shembull se çfarë rrezikojmë në rast se e parapërgatit KQZ-ja dhe e fut në zarf? Se me atë që kuptoj unë, nga mënyra se si është hartuar akti këtu i bie që po çënohet integriteti i punës së KQZ-së, se kështu i bie.

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** Jo ajo nuk e çënon integritetin e punës së KQZ-së.

**Z. M. Çakaj:** Po si? Nëse e printojmë ne, atë çënon.

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** Mund të ketë si të thuash edhe një rrjedhje edhe nga operatori i zarfeve. Po supozojmë që në momentin ...

**Z. M. Çakaj:** Po si do të ketë rrjedhje nga operatori, se ju thatë diçka tjetër më para, që potencialisht mund të votojë dikush në emër të dikujt tjetër. A mund të kemi një shembull, një rast? Meqë keni dhe eksperiencë, në Kosovë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:* Në qoftë se zarfi, një zarf bie në dorë, nuk shkon si të thuash në adresën e votuesit...

*Z. M. Çakaj:* Po pse nuk duhet të shkojë?


*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:*..bie në dorë paraprakisht, ma lër ta mbaroj fjalën. Unë po e shikoj në interesin siç e kishim parë ne po dhe në interesin e të gjithë palëve që do të kenë përfaqësuesi e tyre. Unë, domethënë, në qoftë se një zarf ose një grup zarfesh bie në dorë, nuk shkon në destinacion.

*Z. M. Çakaj:* Po atë e kemi shumë të thjeshtë ne, meqë zgjedhësi ndërvepron me PER-in të shtojmë dhe një element te PER.

*Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:* Sa ta mbaroj fjalën. Supozoj se ka shumë raste që kur jepet adresa, kur votuesi ka dhënë adresën mund ta ketë dhënë me ndonjë gabim dhe adresa nuk vjen në destinacionin e duhur, dakord. Nuk arrin sepse nuk e gjen adresën e plotë, ka një gabim në formatin e adresës që nuk arrin ta sjellë në adresën e duhur, pra operatori mbetet me një tufë zarfesh që nuk i ka çuar në adresën e duhur për një arsye të caktuar dhe këto zarfe bien në një dorë që ka brenda dhe një votë po ka dhe një kod, QR kod të paraprintuar...

*Z. M. Çakaj:* Më fal po kjo është histori kriminale, nuk ka lidhje. Ajo mund të ndodhi, ai është operacion kriminal, ndëshkohet nga ligji, nuk po flasim për atë, po flasim për rregulla ...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** Tani unë po ju jap një shembull që çfarë rrezikon kur ti...

**Z. M. Çakaj:** Çfarë zgjidh nëse kodi unik nuk e printon ose nuk e printon zgjedhësi?

**Znj. A. Smorgrav, përfaqësuese e diasporës:** Ja t'ju jap një shembull tjetër. Nga ana e sistemit të sigurisë nuk mund të japësh edhe një votë ose një diçka që është një pjesë dhe t'i japësh dy pjesë sigurie në të njëjtin zarf. Këtë doja të të thoja. Në qoftë se kjo që thoni ju duhet të bëhet me paraprintim atëherë do të duhet që KQZ-ja të dërgojë dy herë, një herë votën dhe njëherë të dërgojë QR kodin veçmas. Kjo është garancia e sigurisë. Në qoftë se ti i çon në të njëjtin zarf ju krijoni një precedencë të sigurisë, unë e them si eksperte në fushën e IT-së dhe e di shumë mirë se ç'do të thotë siguria dhe si jepen kredencialet. QR kodi është një kredencial, pra është si të thuash një identifikim, ndërsa kur personi vetë do të futet në sistem që ta printojë do të identifikohet me të gjitha hapat, e ka, domethënë rreziku për t'u manipuluar është më i vështirë. Ju bëni si të doni, unë po ju jap një argument në bazë të ekspertizës dhe kjo është dhe arsye që ne kur kemi diskutuar, kemi insistuar madje që QR kodi të jetë i mirëkriptuar me një algoritëm të sigurt etj., etj. dakord, kaq kisha unë vetëm për një sqarim. Kur printon QR kodin ti simulon edhe faktin sikur je në qendrën e votimit, pra merr, identifikohesh dhe pastaj e hedh votën.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit znj. Smorgrav!

**Znj. H. Vukaj:** Vetë fleta e votimit nga jashtë do të ketë QR kod ashtu sikundër ka fleta e votimit nga brenda?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Kjo do duhet parë kur në karakteristikat e fletës së votimit, po Kodi thotë është e njëjtë me fletën brenda vendit, kështu që si për brenda, si për jashtë nuk është një veçanti. Nuk ka lidhje ky kod i cili...

**Znj. H. Vukaj:** Qëllimi ynë është do të ndërtoj një logjikë tjetër sepse zonja tha që QR kodi, që supozohet ta printoni ose...

**Znj. J. Josifi:** Ky është jashtë.

**Znj. H. Vukaj:** Po, pra po.

**Znj. J. Josifi:** Prandaj krijuam një zarf tjetër të ndërmjetëm.

**Znj. H. Vukaj:** Do të shërbejë për rritjen e elementëve të sigurisë dhe në qoftë se ne, ju e printoni dhe ia çoni gati, do thyejë sigurinë, i bie që në qoftë se është e manipuluar adresa ose adresa po përdoret si adresë nga palë të treta, atëherë i bie që si t'ia çosh kodin të printuar, si të mos ia çosh kodin të printuar, i bie që kjo do manipulohet gjithsesi. Pra nuk është çështje e kodit mënyra se si dërgohet kodi, ideja ishte tek lehtësimi, te parimi i lehtësisë. Do menduar një mekanizëm tjetër, u duhet thënë dhe ekspertëve apo znj. Smorgrav, meqenëse qenkërka IT, që të bëjë të mundur thjesht dhe vetëm dhënien e votës në zarf dhe këto elementët e sigurisë të jenë të implementuar tashmë.

**Znj. I. Nano:** Elementë sigurie padyshim që ka fleta e votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Ose vetë zarfi mund ta ketë të fshehtë atë kodin unik në momentin kur prodhohet enkas. A prodhohen këtu në KQZ? Sepse kështu lexon, e ka përmbajtjen një nga pikat dokumentacioni. Pra zarfin ju do ta prokuroni? Llojet e zarfave? Po, atëherë mund të gjeni një mekanizëm që të ketë zarfi një gjë që lidhet, një element që lidhet me zgjedhësin në mënyrë unike. Po zgjedhësi do të të distancohet nuk do të mund ta realizojë dot. Zgjedhësi kudo që të ndodhet sepse zgjedhësi është emigrant nuk është pushues. Zgjedhësi është tërë ditën në punë, nuk ju kushton, domethënë i ha kohë, i duket mundim kjo pjesa që mund të ketë edhe zgjedhës të devotshëm.

**Z. M. Çakaj:** Shmang burokracinë.

**Znj. J. Josifi:** Është çështje atëherë të bëjmë aleancën midis kësaj shkallës së lehtësisë dhe kostos patjetër se dhe ai printimi mund të ketë, qoftë edhe një cent kosto dhe sigurisë që ne kishim qëllim që të adresonim. Nuk është për të shtuar barrën mbi zgjedhësin kjo.

**Znj. I. Nano:** Se në fakt nga drafti fillestar në draftin e sotëm ne një lehtësi ia kemi krijuar zgjedhësit, pra nëse e ngarkonim me barrën e blerjes vetë të këtij zarfit të jashtëm, në këtë propozim që ka ardhur është...Tani këtë e kanë kërkuar shoqatat e diasporës që zarfin e jashtëm t'ia çojë KQZ-ja, në mënyrë që të lehtësohen kostot.

**Znj. J. Josifi:** KRIIK-u e kërkoj.

**Znj. I. Nano:** KRIIK-u e ka kërkuar, pra këtu bëni një vlerësim atë që tha z. Çakaj mes lehtësisë dhe kostove, vlerësimi të risqeve.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Kjo është bërë shumë mirë që është implementuar, pika që po e konsideroni lehtësi, po kjo është element sigurie në fakt, për unifikimin e të gjithë llojeve të zarfave. Kështu që kjo i ka shërbyer procesit të sigurisë më përpara se t'i shërbejë lehtësisë sepse është më kollaj të shkojë në kancelari të blejë dy apo tre zarfa se sa të rrijë të printojë stiker ose ku di unë sipas brezave të gjejë mënyrën e tij për ta ngjitur. Lind pyetja pastaj a do ta quajë të vlefshme KQZ-ja këtë votë të ngjitur sipas mënyrave individuale?

**Z. M. Çakaj:** Një propozim mund të jetë, sigurisht ta vlerësoni ju, mos ta printojë, ta shënojë atje, meqë i vete individualisht ta shënojë.

**Znj. J. Josifi:** Mund të kemi gabime njerëzore aty në të shkruar, pra nuk është e sigurtë, nuk garanton atë që dhe nuk kemi barkode pastaj që dhe ne të ta lehtësojmë skanimin.

**Z. M. Çakaj:** Meqë ka dhe QR kod, printeri nuk është një cilësi të lartë, edhe unë në zyrë s'e kam të cilësisë së lartë për fat të keq dhe mbase s'e lexon QR kodin si do ia bëjmë kësaj radhe?

**Znj. H. Vukaj:** Jeni gati të mendoni bashkë me suportin që po ju japin, ndoshta ato organizatat që ndoshta kanë dhënë kontributin e tyre në draft si juristë apo si IT apo si teknikienë të tjerë me përvoja që të keni variante ose variacione të zëvendësimit të këtij kodi ose mënyrave për të lehtësuar.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Me sa po kuptojmë ne jemi të gjithë në të njëjtën dakordësi që ka nevojë për një kod unik, të zgjedhësit që është regjistruar, që është në listën përfundimtare, që i është dërguar dokumentacioni zgjedhor, diskutimi është vetëm nëse do ta bëjmë ne apo do ta bëjë zgjedhësi. Në këtë projektvendim Komisioneri ka gjykuar që ta bëjë zgjedhësi për arsyen që ju thashë, kështu që mbetet pastaj në vlerësimin tuaj, ky është qëllimi domethënë, kjo është përpjekur të adresohet në këtë pikë këtu.

**Znj. I. Nano:** Ka propozim konkret për nenin, për pikën konkrete?

**Z. M. Çakaj:** Ideja është këtu që administrata të marrë kohën e nevojshme, të vlerësojë të gjithë risqet e mundshme dhe të na vijë jo vetëm me një variant po me disa variante ose minimalisht të kemi në relacion nuk e gjeta të identifikuar si do të procedojmë me rastin se si është propozuar ky akt ose si do të procedojmë në rastin se mund t'i prodhojë vetë KQZ-ja ose dhe varianti të tjera, të ndërmjetme, të mundshme, pra të kemi një zgjidhje optimale duke vlerësuar maksimalisht rrisqet nëse do të prodhohej ky kod unik nga KQZ-ja nga njëra anë në raport me ..që shkojmë në mënyrë masive, shmangim burokracinë, e bëjmë procesin më të lehtë, shtojmë, i japim mundësi dhe e shtojmë masivitetin në proces votimi, mos duket çudi që vetëm nga ky element të mund të kemi një numër më të vogël votash nga jashtë. Unë do të ftoj administratën ta rivlerësonte dhe njëherë këtë dhe e zhvillojmë në një moment të dytë diskutimin, sigurisht mbledhjen dhe të gjitha.

**Znj. I. Nano:** Atëherë ne në qoftë se ngelemi këtu nuk mund të vijojmë me shqyrtimin më tej, një kohë e mjaftueshme kush do të ishte për ju për të patur një informacion?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Nëse do të ketë brenda ditës së nesërme, nëse jo mjafton sot dhe nesër. Sigurisht dhe thirrjen për të vijuar dhe e aktet e tjera nëse i keni gati.

**Znj. J. Josifi:** Thjesht që ta kuptojmë, më e qartë për të adresuar shqetësimin tuaj ose pikëpyetjen. Nuk e kemi problemin te koha, e bëjmë sot, e bëjmë nesër por arsyetimin tonë jua thamë dhe nuk do të ketë një propozim të ri nga ne për këtë pikë.

**Znj. I. Nano:** Një analizë, një vlerësim pra për lehtësinë në raport me...

**Znj. J. Josifi:** Një risk që ne kemi identifikuar për shembull, që kemi menduar është që...

**Znj. I. Nano:** A na i bëni dot, një e keni identifikuar deri tani, mund të identifikoni dhe një nesër.

**Znj. H. Vukaj:** Znj. Smorgrav pak më parë përmendi operatorët, risku nga operatorët. Mund ta heqim këtë dilemën që kemi risk nga operatorët apo jo dhe në qoftë se ka risk, çfarë hapash do të ndërmerrni ju për të prerë këtë risk dhe të tjera risqe që mund të ekzistojnë. Merrni kohën tuaj dhe hajdeni të kompletuar në mundësitë që mund t'i jepen zgjedhësit për ta bërë të realizueshme këtë votë. Se në qoftë se ne pastaj bëjmë sikur po ia çojmë dhe po harxhojmë ca para, po ia çojmë këto zarfe dhe ndërkohë nuk presim për hir të këtij elementi burokratik që po vendosim është çështje që ...

**Znj. J. Josifi:** Po ju thashë që nuk është element burokratik është element sigurie, nuk është element burokratik.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Ka moduse ndoshta e nderuar zonjë, të cilët mund ta zëvendësojnë këtë element sigurie, të mos printohet nga zgjedhësi.

**Znj. I. Nano:** Deri nesër në orën 12 nëse na jepet një informacion.

**Z. M. Çakaj:** Risjell në vëmendjen tuaj megjithë respektin për punën tuaj dhe personalisht mendoj që dy risqe të identifikuara ishin, është tmerrësisht e dhimbshme të mendosh që risk për manipulim do të ketë operatori i shërbimit postar, atë që identifikoi zonja Smorgrav, apo risk për manipulime do të ketë nga KQZ-ja, se vetëm këto dy raste identifikova. Në gjykimin dhe vlerësimin tim risk mund të ketë nga palët e treta jashtë. Persona të interesuar mund të ndërhyjnë në procesin e zgjedhor por jo risk nga operatori i shërbimit postar, duhet ta përjashtojmë këtë si mundësi apo risk nga personi i caktuar në KQZ, se këto raste identifikoi. Nëse nuk kemi një adresim të saktë, një vlerësim të saktë të risqeve, pra po vendosja me heqjen sepse këtu po diskutohet do të kemi një vlerësim risku nga njëra anë për manipulim, në raport me riskun për mosvotim, për heqjen e së drejtës së votës për një burokraci të tepërt, pra t'i vlerësojmë ose për një element sigurie të tepërt. Sido të jetë, kështu që ne nuk e kemi të qartë këtu, në mënyrë që të vlerësojmë dhe të adresojmë tamam këtë propozim konkret.

**Znj. I. Nano:** Atëherë deri nesër në orën 12.00 të kemi nga administrata një informacion ku të adresohen këto shqetësime që u diskutuan. Jeni të mendimit që të bëjmë një takim paraprak pas orës 12.00 me administratën dhe më tej kalojmë në mbledhjen plenare.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 11.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Atëherë mirë do të ishte të kemi një informacion të shkurtër apo të gjatë si ta vlerësojë administrata, me një, dy, tre, katër risqe, çfarë ka identifikuar në raport me atë çfarë mund të arrijmë ne.

**Znj. I. Nano:** Në orën 14.00 lëmë një takim me ju nesër që mundësisht të mblihdemi nesër në orën 15.00.

**Znj. J. Josifi:** Ne po e dërgojmë sa më parë që të mundemi informacionin e shkruar.

**Znj. I. Nano:** Në orën 14.00 një takim konsultativ me njëri-tjetrin. Paraprakisht them që mbledhjen do ta zhvillojmë nesër në orën 15.00, nëse do të ketë, në çdo rast do të merret një do të merrni njoftimin përkatës nëse do të ketë ndryshime nga ky orar do të njoftojmë gjithsesi. Mbledhjen e deklarojmë të mbyllur për sot!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

